

Tiranë, 02.07.2026

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit

Lënda: Komente nga FIAA mbi Projektvendimin "Për miratimin e Politikës Kombëtare për NMV 2026 – 2030"

Në vijim të procesit të konsultimit publik mbi draftin e **Komente nga FIAA mbi Projektvendimin "Për miratimin e Politikës Kombëtare për NMV 2026 – 2030 "** dëshirojmë të ndajmë disa komente dhe pyetje nga perspektiva e anëtarëve tanë në industritë e agro ushqimore.

CESHTJE TE NGRITURA NGA FIAA MBI RELACIONIN PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT POLITIK PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME 2026-2030”

QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Komente nga Biznesi i Huaj ne vend, FIAA:

Ky dokument paraqet nje vizion te qarte per menyren se si Qeveria synon te zhvilloje biznesin shqiptar deri ne vitin 2030: me inovativ, me te digjitalizuar, me te gjelber, me konkurrues dhe me te integruar ne tregun europian.

- **Megjithate, ndersa objektivat strategjike jane te qarta, dokumenti jep me pak qartesi mbi instrumentet konkrete qe do te mbeshtesin arritjen e tyre, si mekanizmat financiare, incentivat, partneritetet publike-private dhe koordinimin me reformat sektoriale ne zbatim.**

Nga kendveshtrimi i kompanive qe operojne ne nje zinxhir te gjere furnizimi dhe bashkepunojne me qindra partnere, furnitore, distributore dhe riciklues, tranzicioni drejt nje ekonomie me te qendrueshme nuk mund te arrihet vetem ne nivel kompanie. Ai kerkon zhvillimin paralel te te gjithe ekosistemit te biznesit.

- **Per kete arsye, do te ishte me vlere qe dokumenti te adresonte me konkretisht mbeshtetjen per ESG, ekonomine qarkulluese, Pergjegjesine e Zgjerruar te Prodhuesit (EPR) dhe sistemet e Depozite-Kthimit (DRS), si instrumente qe rrisin konkurrueshmerine e zinxhirit te vleres dhe jo vetem performancen individuale te nje kompanie.**
- **Po keshtu, duke qene se gjithnje e me shume kompanite raportojne sipas standardeve ESG dhe kerkesave te zinxhirit te furnizimit te partnereve nderkombetare, dokumenti mund te**

theksoje me qarte nevojen per te mbeshtetur NVM-te ne permbushjen e ketyre standardeve. Kjo do te ndihmonte jo vetem kompanite e medha, por edhe furnitoret dhe partneret e tyre, te cilet jane pjese e te njejtit zinxhir vlere dhe ndikojne drejtperdrejt ne performancen e qendrueshmerise, raportimin ESG dhe integrimin ne tregjet europiane.

Në lidhje me RENJK 988 NMV

Si do të adresohet çështja qendrore e pranuar hapur për koordinim të dobët dhe performancë të sistemit? Si do të matet përmirësimi në shpejtësi, burokraci dhe parashikueshmëri?

A do të kompensohen në ndonjë mënyrë kostot e certifikimit, raportimit & pajtueshmërisë me standardet?

Çfarë do të përmirësohet në mënyrë konkrete për bizneset brenda 12–24 muajve?

Financimi i NVM-ve duhet të shkojë përtej kreditimit të bazuar në kolateral bankar.

Me respekt,

Marinela Jazoj
Drejtore, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri